

PHILIPS

Autoparlant me Lidhje Valore
TAS7000E



Manuali i Përdoruesit

Regjistroni produktin tuaj dhe përfitoni mbështetje në:
www.philips.com/support

Përmbajtja

1 E rëndësishme 2

Siguria	2
Kujdesuni për produktin tuaj	3

2 Autoparlanti juaj me lidhje valore 4

Çfarë ka në kuti	4
Vështrim i përgjithshëm mbi autoparlantin	4

3 Fillo 5

Ngarkoni baterinë e integruar	5
Bateri e zëvendësueshme	5
Hap/mbyll	6

4 Riprodho nga pajisjet Bluetooth 6

Lidhni autoparlantin me pajisjen tuaj Bluetooth	6
Treguesi Bluetooth	7
Kontrolloni riprodhimin	7

5 Auracast™ 7

Transmetuesi Auracast™	7
Marrësi Auracast™	8
Çiftimi për modalitetin stereo	8

6 Veçori të tjera 8

Rregulloni ndriçimin	8
Dëgjo një pajisje të jashtme	9
Lidhni një mikrofon të jashtëm	9

7 Aplikacioni Philips Entertainment 10

Shkarkoni aplikacionin	10
Lidhni aplikacionin me autoparlantin tuaj Bluetooth	10
Kontrolli i Zërit	11
Efekti i Dritës	11
Kontrolli i Karaokes	11
Kontrolli i Zërit	12
Cilësimet e përgjithshme	12
Telekomanda virtuale	13
Udhëzuesi i përdoruesit	14

8 Informacioni i produktit 14

9 Zgjidhja e problemeve 15

Të përgjithshme	15
Bluetooth	16

10 Njoftim 16

Përputhshmëria	16
Kujdesi për mjedisin	16
Njoftimi për markën tregtare	17

1 E rëndësishme

Siguria

Udhëzime të rëndësishme sigurie

- Sigurohuni që voltazhi i furnizimit me energji elektrike të korrespondojë me tensionin në anën e pasme ose të poshtme të njësisë.
- Autoparlanti të mos ekspozohet ndaj rënies së pikave ose spërkatjes.
- Shmangni vendosjen e burimeve të rrezikut mbi autoparlant (p.sh. objekte të mbushura me lëngje, qirinj të ndezur).
- Sigurohuni që të ketë hapësirë mjaftueshmërisht të lirë rreth autoparlantit për ajrosje.
- Ju lutem përdorni autoparlantin në mënyrë të sigurt në një mjedis me temperaturë ndërmjet 0°C dhe 40°C.
- Përdorni vetëm kapëse/pajisje shtesë të specifikuara nga prodhuesi.
- Mos e ekspozoni produktin ndaj lëngjeve pa shkëputur lidhjen me kabllo. Mos e ekspozoni produktin ndaj ujit gjatë karikimit. Kjo mund të shkaktojë dëmtime të përhershme në autoparlant ose në burimin e energjisë. Kimikatet, kripa ose "grimcat e huaja" që ndodhen në pishinën tuaj ose oqean mund të dëmtojnë me kalimin e kohës guarnicionet/vulat e papërshkueshme nga uji ose sipërfaqen e lidhësit nëse nuk shpëlahen pas përdorimit. Pas një kontakti me lëngje apo shpëlarjeje, mos e karikoni autoparlantin tuaj përpara se të jetë tharë dhe pastruar plotësisht. Karikimi kur pajisja është e lagësht mund të dëmtojë autoparlantin tuaj.

Masat paraprake për sigurinë e baterisë

- Rrezik shpërthimi nëse bateria është zëvendësuar gabimisht. Zëvendësoni vetëm me të njëjtin lloj ose ekuivalent me të.
- Bateria (paketa e baterisë ose bateritë e instaluar) nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësisë së tepërt si rrezet e diellit, ndaj zjarrit ose të ngjashme me to.
- Bateria në temperatura ekstremisht të larta ose të ulëta gjatë përdorimit, ruajtjes ose transportit si dhe nga presioni i ulët i ajrit në lartësi të madhe mund të krijojë rreziqe për sigurinë.
- Shmagni zëvendësimin e bateri së me llojin e gabuar që mund të prishë mbrojtjen (për shembull, disa lloje baterish litiumi).
- Hedhja e një baterie në zjarr ose në një furrë të nxehtë, ose shtypja ose prerja mekanike e një baterie, mund të rezultojë në një shpërthim.
- Lënia e një baterie në një mjedis me temperaturë jashtëzakonisht të lartë ose në një mjedis me presion jashtëzakonisht të ulët ajri mund të rezultojë në një shpërthim ose rrjedhje të lëngut ose gazit të ndezshëm.

Kujdesuni për produktin tuaj

- Përdorni vetëm leckë mikrofibër për pastrimin e produktit.
- Ju lutem kini parasysh se pajisja juaj përmban bateri të integruara litiumi. Kapaciteti i karikimit të baterive të litiumit do të ulet me kalimin e kohës për shkak të karakteristikave të tyre vetë-shkarkuese. **Për të bërë të mundur jetëgjatësinë e baterisë së pajisjes suaj, rekomandojmë karikimin e baterisë së integruar me litium në rreth 50% çdo 6 muaj kur pajisja nuk është në përdorim.**



Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kutinë e këtij autoparlanti.
- Asnjëherë mos lubrifikoni ndonjë pjesë të këtij autoparlanti.
- Vendoseni këtë autoparlant në një sipërfaqe të sheshtë, të fortë dhe të qëndrueshme.
- Asnjëherë mos e vendosni këtë autoparlant mbi pajisje të tjera elektrike.
- Përdoreni këtë autoparlant vetëm për mjedise të brendshme. Mbajeni këtë autoparlant larg ujit, lagështisë dhe objekteve të mbushura me lëngje.
- Mbajeni këtë autoparlant larg nga rrezet direkte të diellit, nga flakët e hapura ose nga nxehtësia.
- Rrezik shpërthimi nëse një bateri zëvendësohet nga një lloj i gabuar.

2 Autoparlanti juaj me lidhje valore


Urime për blerjen tuaj dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron Philips, regjistroni produktin tuaj në www.philips.com/support.

Çfarë ka në kuti

Kontrolloni dhe identifikoni përmbajtjen e pakos tuaj:

- Autoparlant
- Kablo USB
- Udhëzues për fillimin e shpejtë / fletë sigurie / garanci

Vështrim i përgjithshëm mbi autoparlantin



- 1 Aktivizoni ose çaktivizoni autoparlantin.
- 2 Zgjidhni burimin e audios
- 3 Shtypni dhe mbajeni shtypur për të hyrë në modalitetin e çiftimit ose për të shkëputur një pajisje Bluetooth të lidhur
- 4 Filloni ose ndaloni riprodhimin e audios.
- 5 Ngrini volumin
- 6 Ulni volumin
- 7
 - Shtypni për të hyrë/aktivizuar riskanimin e modalitetit të marrësit Auracast™
 - Shtypni dy herë për të hyrë/dalë nga modaliteti "TWS"
 - Shtypni dhe mbani shtypur për më shumë se 3 sekonda për të aktivizuar/çaktivizuar modalitetin e transmetimit Auracast™
- 8 Rregulloni modalitetin e dritës
- 9 **MIC IN (HYRJA E MIKROFONIT)**
Lidhni mikrofonin e jashtëm.
- 10 **AUDIO IN (HYRJE AUDIO)**
Lidhni pajisjet e jashtme audio
- 11 **IN / OUT (HYRJA / DALJA)**
 - Ngarkoni baterinë e integruar
 - Ngarko një pajisje të jashtme

3 Fillo

Gjithmonë ndiqni udhëzimet në këtë kapitull në vijim.

Ngarkoni baterinë e integruar


Autoparlanti mundësohet nga një bateri e integruar e rikarikueshme.

Shënim



- Karikoni plotësisht baterinë e integruar përpara se ta përdorni.

Lidheni prizën USB-C në autoparlant me një prizë outlet (5V = 3A) duke përdorur kabllon USB të dhënë.

5V = 3A, 9V = 2A, 12V = 2,25A, 15V = 2A, 20V = 1,8A



Dalja: 5V = 2A



LED i Energjisë

- ↳ Gjatë kohës së ngarkimit të autoparlantit, treguesi LED i Energjisë merr ngjyrë të kuqe.
- ↳ Kur autoparlanti të jetë i ngarkuar plotësisht, treguesi LED i Energjisë fiket.
- ↳ Kur niveli i baterisë të bjerë më poshtë se 20%, ju do të dëgjoni thirrje zanore një herë në 60 sekonda.
- ↳ Kur niveli i baterisë të bjerë më poshtë se 2%, autoparlanti do të fiket.




Kujdes

- Rrezik dëmtimi i autoparlantit! Sigurohuni që voltazhi i furnizimit me energji elektrike të përputhet me tensionin e printuar në anën e pasme ose në pjesën e poshtme të autoparlantit.
- Rrezik goditjeje elektrike! Kur shkëputni kabllon USB, tërhiqeni gjithmonë spinën nga priza. Asnjëherë mos e tërhiqni kabllon.
- Përdorni vetëm një kabllo USB të përcaktuar nga prodhuesi ose që shitet me këtë autoparlant.

Bateri e zëvendësueshme

Dera e baterisë ndodhet në pjesën e poshtme dhe është e siguruar me katër vida. Me heqjen e vidave, bateria mund të zëvendësohet lehtësisht.



E zbatueshme vetëm me baterinë Philips TACR5002BA/00.

Hap/mbyll

Shtypni  për të ndezur autoparlantin.

↳ Do të dëgjoni tingullin e shpejtë.

Për të fikur autoparlantin, shtypni  edhe një herë.

↳ Do të dëgjoni tingullin e shpejtë.

Shënim

- Autoparlanti do të fiket automatikisht pas 15 minutash nëse nuk detektohet asnjë sinjal audio nga Bluetooth / Auracast / USB / Audio In.

4 Riprodho nga pajisjet Bluetooth

Lidheni autoparlantin me pajisjen tuaj Bluetooth

Me këtë autoparlant, ju mund të argëtoheni me audio nga pajisja juaj Bluetooth.


Shënim

- Sigurohuni që pajisja juaj të ketë të aktivizuar funksionin Bluetooth.
- Distanca maksimale për çiftimin e autoparlantit dhe pajisjes tuaj Bluetooth është 30 metra (99 këmbë).
- Mbajeni larg nga çdo pajisje tjetër elektronike që mund të shkaktojë ndërhyrje/interferencë.

1. Shtypni  për të ndezur autoparlantin. Do të hyjë automatikisht në modalitetin e çiftimit Bluetooth me dritën blu që pulson ngadalë. Gjithashtu ju mund të shtypni dhe mbani të shtypur  për t'u futur në modalitetin e çiftimit Bluetooth.
2. Aktivizoni Bluetooth dhe zgjidhni "**Philips S7000E**" në listën Bluetooth në pajisjen tuaj për çiftim.
3. Luani audio në pajisjen tuaj Bluetooth për të nisur transmetimin e muzikës.

Treguesi Bluetooth

Treguesi LED	Statusi i Bluetooth
Pulson shpejt në ngjyrë blu	Gati për çiftim
Pulson ngadalë në ngjyrë blu	Po rilidh pajisjen e fundit të lidhur
Blu e forte	I lidhur




Kontrolloni riprodhimin

Gjatë riprodhimit të muzikës

- Shtypni për të ndaluar ose rifilluar laujtjen
- ▶▶ Shtypni dy herë për të kaluar tek kënga tjetër
- Shtypni tre herë për të lajuar këngën e mëparshme
- Shtypni pak për të ulur/rritur një nivel të volumit
- /+ Shtypni dhe mbajeni shtypur për të ulur/rritur vazhdimisht volumin

5 Auracast™

Përdorni **Auracast™** për t'u çiftuar me një autoparlant tjetër S7000E për stereo (TWS), për të marrë transmetime nga të tjerët ose për të nisur transmetimin tuaj në autoparlantë të tjerë të përputhshëm.



Transmetuesi Auracast™

Cilësimi i parazgjedhur i transmetimit Auracast™ në produkt është **Public** (transmetim i pakriptuar). Mund të zgjidhni **Personal** (transmetim i koduar) dhe të vendosni një fjalëkalim nën **Aplikacioni Philips Entertainment => General Settings => Auracast™ Broadcaster**.

1. Për të filluar një transmetim, shtypni dhe mbani shtypur  për 3 sekonda ose në **aplikacion Entertainment** zgjidhni **Setup PartyLink mode** në **General Settings**. Drita LED Auracast™ në produkt bëhet vjollcë (Publik) / qelibar (Personal) dhe do të dëgjoni një tingull paralajmërues.
2. Për të ndaluar transmetimin, shtypni dhe mbani shtypur  për 3 sekonda përsëri ose zgjidhni **Unlink** në aplikacion. Drita LED Auracast™ fiket dhe ju do të dëgjoni një tingull paralajmërues

Marrësi Auracast™

1. Për të kërkuar një transmetim, shtypni  ose shkoni te Aplikacioni Entertainment për të kaluar te **Auracast™ Receiver** nën **Source control**. Drita LED Auracast™ bëhet bojëqielli dhe do të dëgjoni një tingull të menjëhershëm.

Autoparlanti do të kërkojë automatikisht transmetimet Auracast™ aty pranë dhe do të lidhet me transmetimin e pakriptuar me sinjalin më të fortë.

2. Për të dalë nga një transmetim, shtypni dhe mbani shtypur  për 3 sekonda ose kaloni në një burim tjetër në Aplikacion.

Çiftimi për modalitetin stereo


Dy autoparlantë identikë me valë (Philips S7000E) mund të çiftohen me njëri-tjetrin për tingull stereo.

1. Për të filluar, autoparlanti i lidhur me pajisjen tuaj Bluetooth do të përdoret si autoparlant kryesor. Shtypni dy herë  në të dy autoparlantët, do të dëgjoni një tingull të menjëhershëm dhe drita LED e Auracast do të pulsojë me ngjyrë të bardhë gjatë çiftimit dhe do të bëhet rozë pasi të lidhet.
2. Në modalitetin stereo, të gjitha veprimet sinkronizohen ndërmjet të dy autoparlantëve. Mund të kontrolloni riprodhimin, të rregulloni volumnin dhe të ndryshoni modalitetin e dritës nga secili prej autoparlantëve.
3. Për të dalë, shtypni dy herë  në njërin prej autoparlantëve.

6 Veçori të tjera

Rregulloni ndriçimin

Shtypni  në autoparlant ose përmes  në aplikacion për të kontrolluar efektin e dritës.



Light Effect


- ☐ Off
- ☒ Mode 1
- ☐ Mode 2
- ☐ Mode 3
- ☐ Mode 4
- ☐ Mode 5

Cancel


OK

Dëgjo një pajisje të jashtme

- Përdorni një kabllo 3,5 mm (nuk përfshihet) për të lidhur një pajisje të jashtme përmes portës AUX IN në autoparlant. Shtypni  për të zgjedhur **Audio In** për riprodhimin e audios ose zgjidheni nga aplikacioni.
- Ose përdorni një USB-C në kabllo A (nuk përfshihet në paketim) për të lidhur produktin me laptopin/pajisjet tuaja, zgjidhni Philips S7000E USB në pajisjen tuaj për të luajtur zërin përmes saj. Shtypni  për të zgjedhur **USB** për riprodhimin e audios ose zgjidheni nga aplikacioni.



Lidhni një mikrofon të jashtëm




7 Aplikacioni Philips Entertainment

Aplikacioni ynë i dobishëm shoqërues ju lejon të zgjidhni një burim zanor, të kontrolloni riprodhimin dhe funksionin Bas+, të kaloni midis modaliteteve të ndryshme të ndriçimit, të kontrolloni jetëgjatësinë e baterisë dhe shumë më tepër. Gjithashtu, aplikacioni përmban një funksion "PartyLink", që të lejon të lidhesh lehtësisht me autoparlantë të tjerë përmes teknologjisë Auracast™, për një tingull edhe më të fuqishëm.



Shkarkoni aplikacionin

Skanoni kodin QR/shtypni butonin "Shkarko" ose kërkoni "Philips Entertainment" në Apple App Store ose Google Play për të shkarkuar aplikacionin.



philips.to/entapp


Lidhni aplikacionin me autoparlantin tuaj Bluetooth



- 1 Hapni aplikacionin Philips Entertainment në pajisjen tuaj celulare, shtypni opsionin 'Add device +' për të zbuluar Philips S7000E. Sigurohuni që Bluetooth të jetë i aktivizuar në pajisjen tuaj celulare.
- 2 Kur lidhni aplikacionin me autoparlantin tuaj për herë të parë, do t'ju kërkohet të çiftoni aplikacionin me autoparlantin tuaj. Shtypni ► në autoparlantin tuaj për të konfirmuar lidhjen e Aplikacionit.

Sapo autoparlanti juaj të jetë i lidhur me aplikacionin Entertainment, mund të shijoni të gjitha funksionet shtesë dhe të vendosni preferencat tuaja lehtësisht pra ta personalizoni sipas dëshirës.

Kontrolli i Zërit



Efekti i Dritës



Light Effect


- ☐ Off
- ☒ Mode 1
- ☐ Mode 2
- ☐ Mode 3
- ☐ Mode 4
- ☐ Mode 5

Cancel

OK


Kontrolli i Karaokes

Lidhni mikrofonin tuaj (i cili nuk përfshihet) në portën MIC IN dhe përdorni aplikacionin për ta konfiguruar.




Kontrolli i Zërit


Shtypni ikonën  në Aplikacion për të zgjedhur  Bluetooth / Auracast receiver / USB  Relaxation / Concentration / Masking  Generative / Ambient / Nature



Cilësimet e përgjithshme

Me  ju mund të vini re që ka një version të ri të firmware-it në dispozicion për përditësim.






Konfiguroni modalitetin PartyLink

Për të blerë më shumë autoparlantë S7000E ose autoparlantë të tjerë të markës Philips që mbështesin Auracast™, dhe për të shijuar funksionin PartyLink, ndiqni hapat në aplikacion për t'i çiftuar lehtësisht të gjithë së bashku.




Telekomanda virtuale

Rrëshqitni ikonat e menisë majtas derisa të gjeni ikonën . Shtypeni atë për të hyrë në ndërfaqen e telekomandës virtuale. Mund ta përdorni telekomandën virtuale për të riprodhuar muzikë dhe për të rregulluar çdo cilësim të autoparlantit.



Udhëzuesi i përdoruesit

Rrëshqitni ikonat e menusë majtas derisa të gjeni ikonën . Shtypeni për të kontrolluar manualin e përdoruesit dhe udhëzuesin e shpejtë të nisjes për më shumë informacion rreth përdorimit të këtij autoparlanti.



8 Informacioni i produktit



Shënim

- Informacioni i produktit është subjekt i ndryshimit pa njoftim paraprak.

Informacion i përgjithshëm

Portë hyrëse USB-C për karikim	5V = 3A, 9V = 2A, 12V = 2,25A, 15V = 2A, 20V = 1,8A
Dalja e karikimit USB-C	5V = 2A
Bateri litiumi e integruar	5200 mAh
Përmasat (Gja x L x Gjë)	312x188x149,5mm
Pesha (njësia kryesore)	2,844kg
Ambienti i funksionimit	0°C - 40°C

Autoparlant

Fuqia e daljes (RMS)	50W vufer 40W THD 10% tweeter 10W THD 1%
Përgjigja e frekuencës	60Hz-20kHz
Raporti sinjal zhurmë	>82dB
Impedanca	4 Ω
Fuqia maksimale e hyrjes	55W
Drajveri	G115*Gj90mm

Autoparlant Tweeter

Impedanca	4 Ω
Fuqia maksimale e hyrjes	13W
Drajveri	Diametri 39,5mm
Radiatorë pasivë	2

Bluetooth

Versioni i Bluetooth	5.4
Rrezja e frekuencës	2402 ~ 2480 MHz
Fuqia maksimale e transmetimit	≤10dBm
Profilat e përputhshme Bluetooth	Mbështet A2DP/AVRCP
Rrezja e shtrirjes së Bluetooth	zonë e hapur për Bluetooth deri në 30 m, TWS deri në 10 m.

9 Zgjidhja e problemeve



Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kutinë e këtij autoparlanti.

Për të mbajtur garancinë të vlefshme, mos u përpiqni kurrë ta riparoni vetë autoparlantin.

Nëse hasni probleme gjatë përdorimit të këtij autoparlanti, kontrolloni pikat e mëposhtme përpara se të kërkonit shërbim. Nëse problemi mbetet i pazgjidhur, shkoni në faqen e internetit të Philips (www.philips.com/support). Kur kontaktoni Philips, sigurohuni që autoparlanti të jetë në afërsi dhe se numri i modelit dhe numri i serisë janë të disponueshëm.

Të përgjithshme

Nuk ka energji

- Sigurohuni që autoparlanti të jetë plotësisht i ngarkuar.
- Sigurohuni që priza USB e autoparlantit të jetë e lidhur siç duhet.
- Si veçori e kursimit të energjisë, autoparlanti fiket automatikisht 15 minuta pas mungesës së një sinjali audio.

Nuk ka zë

- Rregulloni volumin në këtë autoparlant.
- Rregulloni volumin në pajisjen e lidhur.
- Sigurohuni që pajisja juaj Bluetooth të jetë brenda intervalit operativ.

Asnjë përgjigje nga autoparlanti

- Ristartoni autoparlantin.

Bluetooth

Cilësia e audios është e dobët pas lidhjes me një pajisje të aktivizuar me Bluetooth

- Marrja me Bluetooth është e dobët. Lëvizeni pajisjen më afër këtij autoparlanti ose largoni çdo pengesë midis tyre.

Nuk arriti të gjente [Philips S7000E] në pajisjen tuaj Bluetooth për çiftim

- Shtypni dhe mbani shtypur  për 3 sekonda për të hyrë në modalitetin e çiftimit Bluetooth dhe më pas provoni përsëri.

Nuk mund të lidhet me pajisjen tuaj Bluetooth

- Funkzioni Bluetooth i pajisjes nuk është i aktivizuar. Referojuni manualit të përdorimit të pajisjes suaj për të zbuluar se si duhet aktivizuar funksioni.
- Autoparlanti nuk është në modalitetin e çiftimit.
- Ky autoparlant është i lidhur tashmë me një pajisje tjetër të aktivizuar me Bluetooth. Shkëputeni dhe provoni përsëri.

10 Njoftim

Çdo ndryshim ose modifikim i bërë në këtë pajisje që nuk është miratuar shprehimisht nga MMD Hong Kong Holding Limited mund të anulojë autoritetin e përdoruesit për të përdorur produktin.

Përputhshmëria



Nëpërmjet këtij dokumenti, TP Vision Europe B.V. deklaron se produkti është në përputhje me kërkesat bazë dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës RED 2014/53/EU dhe UK Radio Equipment Regulations SI 2017 No 1206. Deklarata e Konformitetit mund të gjendet në www.philips.com/support.

Kujdesi për mjedisin

Asgjësimi i produktit dhe baterisë tuaj të vjetër



Produkti juaj është konceptuar dhe prodhuar me materiale dhe përbërës të cilësisë së lartë, të cilët mund të riciklohen dhe ripërdoren.



Ky simbol në një produkt do të thotë që produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.




Ky simbol nënkupton se produkti përmban bateri të mbuluara nga Rregullorja Evropiane (EU) 2023/1542, të cilat nuk mund të hidhen me mbeturinat e zakonshme shtëpiake.



Simboli tregon tensionin DC (rrymën e drejtpërdrejtë)

Informohuni për sistemin lokal të grumbullimit të veçantë për produktet dhe bateritë elektrike dhe elektronike. Ndiqni rregullat lokale dhe mos e hidhni kurrë produktin dhe bateritë me mbeturinat e zakonshme shtëpiake. Asgjësimi i duhur e produkteve dhe baterive të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Hiqni baterinë e integruar.



Vetëm për qëllime ilustrimi

Njoftimi për markën tregtare



Marka e fjalës dhe logot Bluetooth® janë marka tregtare të regjistruara në pronësi të Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet me licencë. Markat dhe emrat e tjerë tregtarë janë ato të pronarëve të tyre përkatës.



Emri dhe logot Auracast™ janë marka tregtare të pronësisë së Bluetooth SIG, Inc., dhe çdo përdorim i këtyre markave nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet me licencë. Markat dhe emrat e tjerë tregtarë janë ato të pronarëve të tyre përkatës.



Be responsible
Respect copyrights

Krijimi i kopjeve të paautorizuara të materialeve të mbrojtura nga kopjimi, duke përfshirë programe kompjuterike, skedarë, transmetime dhe regjistrime zanore, mund të shkelë të drejtat e autorit dhe të përbëjë një vepër penale. Kjo pajisje nuk duhet të përdoret për qëllime të tilla.



Specifikimet mund të ndryshojnë pa paralajmërim.

Philips dhe stema Philips Shield janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë.

Ky produkt është prodhuar dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited ose një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi në lidhje me këtë produkt.

TAS7000E_00_UM_SQ_V1.0

